



**Procesverbali nga Dëgjimi Publik me banorët e fshatit Bukosh
për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029**

Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatit Bukosh u mbajtë më: 22.05.2026 në SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Bukosh, Komuna Suharekë, me fillim në ora 19:00.

Dëgjimin e shpalli të hapur Kryetari i fshatit , z. Shqipron Sopa, i cili përshëndeti pjesmarrësit dhe stafin Komunal të përbërë nga : Kymete Bajraktari-Drejtoreshën për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Amir Hoxhën-Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë si dhe Florinda Isufaj-Zyrtare Ligjore në DSHPE.

Amir Hoxha - Amir Hoxhën- Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, përshëndeti dhe falenderon pjesmarrësit, prezantoi investimet kapitale të planifikuara për vitin 2026, si dhe i njofton banorët që sipas kërkesave të kryesisë së fshatit në bashkëpunim me përfaqësuesit e lagjeve procedura e inicimit për rregullimin e rrugëve në fshatin Bukosh për vitin 2026 i është dorëzuar Zyrës së Prokurimit.

Kymete Bajraktari- Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përshëndeti dhe falenderoi pjesmarrësit, duke filluar me prezantimin e Planifikimit Buxhetor për vitin 2027-2029. Ajo theksoi se ky takim është organizuar për të ndëgjuar kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për shqyrtim të mëtejshëm.

Driton Krasniqi- Të nderuar përfaqësues të Komunës dhe bashkëfshatarë,

Në kuadër të dëgjimit publik për Kornizën Afatmesme të Buxhetit 2027–2029, paraqesim këto propozime dhe prioritetet që konsiderojmë të rëndësishme për zhvillimin e fshatit tonë:

1. Infrastrukturë rrugore

- Asfaltimi dhe sanimi i rrugëve lokale që janë në gjendje të dëmtuar:
 1. Rr. 3 Maji (1,2,3 pjesë)
 2. Rr. Izet Halili, vazhdim.
 3. Rr. Haxhi Zyba-aneks (te Agim&Sejdi Zyba)
 4. Rr. Sahit Krasniqi (Aneks)
 5. Rr. Jonuz Baraliu vazhdim deri te rruga Nexhat Zyba
- Ndërtimi i trotuareve
 1. Segmenti: Rr. Vija e Frontit deri te Rr. Nexhat Zyba,
 2. Segmenti: Rr. Murat Prenat - Rr. Haxhi Zyba - Rr. Ganimete Sopa
 3. Rr. Njazi Sopa,
 4. Rr. Mentor Krasniqi,
 5. Rr. Sahit Krasniqi)
 6. Rr. Ylli Baraliu

- Ndrëçimit publik
 1. Rr. Blerim Krasniqi
 2. Rr. Mentor Krasniqi, vazhdim
 3. Rr. Izet Halili
- Hapja e rrugeve fushore.
 1. Prane rruges Ylli Baraliu (Te Rrahinat),
 2. Segmenti nga rruga Sahit Krasniqi, Kodra e Beqve e deri te varrezat e Baralive.

2. Ujësjellësi dhe kanalizimi

- Investime në zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit.
- Ndërtimi dhe funksionalizimi i kanalizimit në lagjet ku ende mungon.
- Mirëmbajtje e rregullt e rrjetit ekzistues.

3. Arsimi dhe rinia

- Përmirësimi i kushteve në shkollë dhe pajisja me mjete moderne mësimore.
- Krijimi i hapësirave sportive dhe rekreative për të rinjtë –
 1. Rregullimi i fushës së sportit në oborrin e shkolles (shtruarja e fushës me bari artificial ose me tartan)
- Mbështetje për aktivitete sportive, kulturore dhe edukative
 1. Turniri tradicional i voleybollit “Genc Zyba”.

4. Bujqësia dhe zhvillimi ekonomik

- Mbështetje më e madhe për fermerët përmes subvencioneve komunale.
- Përmirësimi i rrugëve bujqësore dhe sistemit të ujitjes.
- Krijimi i programeve që ndihmojnë punësimin dhe zhvillimin e bizneseve lokale.

5. Mjedisi dhe mirëmbajtja publike

- Vendosja e 3 kabinave për udhëtarët në 3 stacione:
 1. Te shkolla,
 2. Te lagja Sopaj,
 3. Te lagja Baralive.
- Vendosja e kontejnerëve public neper vende kyqe me te frekuentuara.
- Mbjellja e drunjve
 1. Rr. Nga varrezat e lagjës Baraliu dhe Rr.Ylli Baraliu deri te rruga kryesore.

6. Përkujtimoret dhe trashëgimia historike


- Ndërtimi i Lapidarit të Dëshmorëve dhe martirëve (në qendër të fshatit).
- Ndërtimi I pllakes perkujtimore te vendi masakres te shkolla e fshatit.
- Mirëmbajtja dhe rregullimi i lapidarëve dhe vendeve përkujtimore.
- Mbështetje për aktivitetet përkujtimore dhe ruajtjen e historisë së fshatit.
- Rrethojat e varrezave te fshatit.

Përfundim:Kërkojmë që këto prioritete të përfshihen në draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029, pasi ato ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve të fshatit tonë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Faleminderit për mundësinë dhe bashkëpunimin!

Takimi përfundoi në orën : 19:50

Procesmbajtëse : Florinda Isufaj





Lista e pjesëmarrësve në dëgjime publike në BUKOSH

Data: 22.05.2026

Nr	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nënshkrimi	Nr.tel
1	Labinot Fyba	Bukosh	Fyba	049-225-53
2	Shqipron Sopu	Bukosh	SH. Sopu	049-236-144
3	Driton Kraeniqi	Bukosh	Kraeniqi	044224587
4	Aremi Baralig	Bukosh	Baralig	04435698
5	Falih Koçelli	Bukosh	Koçelli	049 252253
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				